



Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Fadil Fazliut, Isni Kilajt dhe Hajredin Kuçit në lidhje me pretendime për ndikim të paligjshëm ndaj dëshmitarëve, më 5 shkurt, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese hodhi poshtë një kërkesë referuese të z. Thaçi.

Z. Thaçi pretendonte se caktimi i gjykatësit të vetëm që urdhëroi masat hetimore të posaçme dhe caktimi i mëpashtëm i të njëjtit si gjykatës i procedurës paraprake nuk ishte në përputhje me ligjin dhe rrjedhimisht kishte shkelur të drejtën e tij që akuzat penale kundër tij të vërtetohen nga një gjykatë e krijuar me ligj. Ai pretendoi gjithashtu për shkelje të së drejtës së tij për jetë private dhe familjare.

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese e hodhi poshtë kërkesën duke e konstatuar të parakohshme, meqë në këtë fazë të procesit është vështirë të vërtetohet nëse janë shkelur të drejtat themelore të z. Thaçi, përpara se të merret vendim i formës së prerë lidhur me këtë çështje gjyqësore. Dhoma konstatoi se z. Thaçi nuk kishte dhënë asnjë shembull, as hollësi, se si masat kishin shkelur të drejtën e tij për privatësi dhe e shpalli pretendimin të pabazë.

Po në këtë çështje, më 10 shkurt, Bashkim Smakaj dhe Fadil Fazliu u liruan përkohësisht në Kosovë me kushte, pas rishikimit të fundit të paraburgimit nga Gjykatësi i Vetëm.

Në vendimin e 3 shkurtit 2026, Gjykatësi konstatoi se rrethanat kishin ndryshuar që prej rishikimit të fundit të paraburgimit të z. Smakaj dhe z. Fazliu në dhjetor 2025 dhe se mbajtja e tyre në paraburgim nuk ishte më e arsyeshme, as proporcionale. Ndonëse Gjykatësi konstatoi se vazhdon të ekzistojë rrezik i moderuar që, në qoftë se lirohen, që të dy, z. Smakaj dhe z. Fazliu do të pengojnë procesin, ai arriti në përfundimin se këto rreziqe nuk peshojnë më shumë se e drejta themelore e tyre për liri.

Gjykatësi mbajti parasysh, ndër faktorë të tjerë, kohën që z. Smakaj dhe z. Fazliu kanë kaluar në paraburgim, që tani tejkalon dënimin më të ulët të parashikuar me ligj që do të merrte secili prej tyre në rast të shpalljes së fajësisë.

Në përputhje me standardet ndërkombëtare të gjykimit të drejtë dhe Kushtetutën e Kosovës, një person i akuzuar mund të mbahet në paraburgim para shpalljes së fajësisë vetëm kur gjykatësit konstatojnë ekzistencën e rreziqeve që përlligjin paraburgimin. Gjykatësit vlerësojnë çdo dy muaj, për çdo të paraburgosur, nëse këto rreziqe ende ekzistojnë, nëse për to mund të gjenden zgjidhje përmes masave alternative dhe nëse mbajtja në paraburgim është e arsyeshme dhe proporcionale.





Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, gjatë kësaj jave po paraqiten deklaratat përmbyllëse. Zyra e Prokurorit të Specializuar filloi paraqitjen e deklaratës së vet të hënën paradite dhe përfundoi të martën. Mbrojtja e Viktimave paraqiti deklaratën përmbyllëse të martën.

Mbrojtja e Hashim Thaçit filloi paraqitjen e deklaratës përmbyllëse dje paradite, vijuar nga Mbrojtja e Kadri Veselit pasdite. Mbrojtja e Veselit vazhdon paraqitjen e deklaratës dhe sot.

Pas kësaj, Mbrojtja e Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit janë planifikuar të paraqesin deklaratat përmbyllëse të tyre. Parashtrimet e Mbrojtjes pritet të vazhdojnë gjatë kësaj jave dhe deri në fillim të javës që vjen.

Pasi Trupi Gjykues të mbyllë çështjen, ai do të fillojë kuvendimet konfidenciale.

Gjykatësit do të vlerësojnë me kujdes besueshmërinë e dëshmitarëve, mbështetshmërinë dhe peshën e dëshmive të dëshmitarëve dhe të secilës provë.

Të akuzuarit prezumohen të pafajshëm, përveç nëse Prokuroria vërteton fajësinë e tyre jashtë dyshimit të arsyeshëm.

Po në këtë çështje, Trupi Gjykues vendosi vazhdimin e paraburgimit të Hashim Thaçit, pas rishikimit të fundit të paraburgimit nga gjykatësit nëse paraburgimi i tij është ende i domosdoshëm dhe i arsyeshëm.

Në vendim, Trupi Gjykues vlerësoi, bazuar në standardin përkatës, se ekziston rrezik i mjaftueshëm që z. Thaçi do të pengojë ecurinë e procesit të Dhomave të Specializuara dhe do të kryejë vepra penale të tjera kundër atyre që konsiderohen kundërshtarë të UÇK-së, përfshirë dëshmitarë të cilët kanë dhënë dëshmi në këtë çështje dhe/ose që mund të thirren në procese paralele.

Ndër faktorë të tjerë, gjykatësit rikujtuan konstatimet e mëparshme të tyre që duket se z. Thaçi: u dha vizitorëve jo të privilegjuar informacion të marrë gjatë dhënies së dëshmive prej dëshmitarëve të mbrojtur; dhe/ose diskutoi udhëzime që duhej t'u kaloheshin dëshmitarëve në lidhje me formën dhe përmbajtjen e dëshmive të tyre. Gjykatësit mbajtën parasysh gjithashtu se “në Kosovë vazhdon të ekzistojë atmosfera e frikësimit të dëshmitarëve dhe ndërhyrjes në procedurat penale kundër anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“UÇK”), që nuk mund të mënjanohet vetëm me masa mbrojtëse.”

Në lidhje me zbatimin e dënimit të Haxhi Shalës, Kryetarja e DHSK-së vendosi të modifikojë dënimin e tij dhe mundësoi lirin me kushte të përcaktuara në vendim. Z. Shala u lirua dhe u kthye në Kosovë këtë javë, më 10 shkurt.

Në vendimin e saj, Kryetarja e DHSK-së përmendi, ndër faktorë të tjerë, se z. Shala ka treguar shenja rehabilitimi dhe se ka dërguar një letër në cilën shprehu keqardhje për cilindo që mund të ketë pësuar dëme





si rezultat i veprimeve të tij. Kujtomë, se z. Shala u vetëdeklarua fajtor për pengim të personave zyrtarë dhe frikësim gjatë procedurës penale dhe u dënua me tre vjet burgim.

Procedurat lidhur me uljen, modifikimin apo ndryshimin e dënimeve, siç parashihet në nenin 51(2) të Ligjit, janë procedura individuale. Kur një person i dënuar i ka vuajtur dy të tretat e dënimit, ai i plotëson kriteret për shqyrtimin e uljes, modifikimit apo ndryshimit të dënimit, por nuk ka automatikisht të drejtë që dënimi t'i ulet, modifikohet apo ndryshohet.

Pyetjet e bëra

Një gazetare e RTK-së pyeti se kur mund të pritët lëshimi i aktgjyqimit në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Zëdhënësi shpjegoi se, mbi bazën e Rregullores së Procedurës dhe të Provave, vendimi i gjyqimit duhet të shqiptohet brenda 90 ditësh nga mbyllja e çështjes. Nëse në varësi të rrethanave nevojitet kohë shtesë, është e mundshme një zgjatje e afatit prej 60 ditësh.

Gazetarja kërkoi koment në lidhje me kritikën ndaj drejtësisë së procesit.

Zëdhënësi shpjegoi se roli i Trupit Gjyqësor është të shqyrtojë me kujdes argumentet e të dy palëve dhe çdo provë brenda kontekstit të tërësisë së provave të pranuar dhe të marrë vendim mbi bazën e provave të paraqitura dhe ligjit. Rregulloret e DHSK-së mbështeten në praktikën më të mirë të gjykatave të tjera për garantimin e gjyqimeve të drejta, të paanshme dhe të pavarura.

